



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	SP-02
Nr. i Prot. Prot. No.	5683-2/4
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	✓ 06 -
Data: Date:	24.09.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	22.09.2025
REFERENC-Ë:	25/5683/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"SHINY 1" Sh.p.k. Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 25/5683/441/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për kompaninë "SHINY 1" Sh.p.k. Prizren - për fabrikën për prodhim të sapunit, detergjenteve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura në ngastrën kadastrale me nr. në ngastrën kadastrale P-71813046-02273-0 Z.K. Lubizhdë, Prizren.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958/23 datë 13.07.2023), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Kompania "SHINY 1" Sh.p.k. Prizren, pajiset me Pëlqim Mjedisor për veprimtarinë: për fabrikën për prodhim të sapunit, detergjenteve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura në ngastrën kadastrale P-71813046-02273-0 Z.K. Lubizhdë, Prizren, nën kushtet si vijon:

- Të gjitha aktivitetet e subjektit duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligjin për Ujërat, Ligjin për Mbeturina, si dhe aktet nënligjore përkatëse.

Kontrolli i emisioneve në ajër:

- Të vendosen pajisje për filtrimin dhe reduktimin e emisioneve të dëmshme (p.sh. VOC, grimca, gazra acidik).

- Të realizohet monitorim periodik i emisioneve në ajër dhe të raportohen rezultatet te autoriteti përkatës.
- Përdorimi i substancave që lëshojnë ndotës në ajër të jetë i kufizuar dhe i kontrolluar. Duhet të sigurohet që lëndët kimike të përdorura të jenë të etiketuara në mënyrë të saktë dhe të pajisura me Fletë të Dënave për Sigurinë (MSDS), si dhe të ruhen në kushte të sigurta që parandalojnë rrjedhjet, derdhjet dhe avullimin.

Menaxhimi i ujërave

- Të instalohet sistem për trajtimin e ujërave të ndotura industriale para shkarkimit në rrjetin publik ose trupat ujore.
- Të monitorohen parametrat e ujit (pH, BPK, detergjentë, substanca të ngurta, etj.).
- Të ndalohet shkarkimi i ujërave të ndotura pa trajtim paraprak. Ndalohet ndikimi negativ ndaj zonave të mbrojtura, habitateve natyrore apo zonave me biodiversitet të ndjeshëm. Nëse aktiviteti zhvillohet pranë një zone të tillë, duhet të zbatohen masa të veçanta mbrojtëse.

Menaxhimi i mbeturinave

- Mbeturinat e rrezikshme dhe të parrezikshme të ndahen, klasifikohen dhe trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.
- Të ruhen në mënyrë të sigurt dhe të transportohen vetëm nga operatorë të licencuar.
- Të mbahet regjistër i plotë për mbeturinat dhe mënyrën e trajtimit të tyre.

Përdorimi dhe ruajtja e kimikateve

- Të përdoren vetëm kimikate të lejuara dhe të miratuara sipas Ligjit për Kimikatet dhe rregulloret e BE-së (REACH, CLP).
- Çdo kimikat duhet të shoqërohet me Fletë-datën e Sigurisë (SDS) në gjuhën shqipe dhe serbe.
- Kimikatet të ruhen në magazina të dedikuara, të ajrosura dhe të mbrojtura nga rrjedhjet.
- Të etiketohet çdo enë në përputhje me standardet ndërkombëtare të rrezikut.
- Të ndalohet përdorimi i substancave të ndaluara me ligj ose të listuara si POPs ose substanca CMR.
- Të përgatiten plane emergjente për rastet e derdhjeve ose aksidenteve me kimikate.
- Të trajnohen punëtorët për përdorimin dhe menaxhimin e sigurt të kimikateve.

Masat tjera

- Të ndërmerren masa për kursimin e ujit dhe energjisë në të gjitha proceset e prodhimit.
- Të përdoren teknologji me efikasitet të lartë energjetik dhe sistemet për ripërdorimin e ujit.
- Të përgatitet një plan për menaxhimin e emergjencave që përfshin rrjedhjet, zjarret, shpërthimet dhe aksidentet kimike.
- Plani të përmbajë numrat e urgjencës, mënyrën e veprimit dhe ekipet përgjegjëse.
- Të sigurohet njoftimi i menjëhershëm i autoriteteve në rast incidenti.
- Të bëhet nivelizimi, gjelbërimi i terrenit dhe rregullimi i rrethojës së terrenit afër fabrikës;
- Të bëhet plani për masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit, gjatë zbatimit të projektit si dhe pas përfundimit të tij;
- Subjekti duhet të lejojë inspektimet nga autoritetet kompetente pa paralajmërim dhe të vendosë në dispozicion të gjitha dokumentet dhe të dhënat relevante për mjedisin.
- Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura duhet t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lartëcekura, pëlqimi do të anulohet (revokohet).

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar, nga kompania "SHINY 1" Sh.p.k. Prizren për Pëlqim Mjedisor për veprimtarinë: fabrikën për prodhim të sapunit, detergjenteve, produkteve të pastrimit dhe preparateve për shkëlqim si dhe pallomave të terura në ngastrën kadastrale P-71813046-02273-0 Z.K. Lubizhdë, Prizren, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nxjerrë Vendim për Lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqim Mjedisor lëshohet, konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181.

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Lejet Ujore dhe Lejen Mjedisore.

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 të Ligjit për VNM 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 25/5683/ZSP/ /25 datë: 22.09.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. *Parashtruesit të kërkesës*
2. *Komisionit për VNM*
3. *Inspektoratit*
4. *Kabinetit të Ministrit*
5. *Komunës së Prizrenit;*
6. *Divizionit për komunikim me publikun*
7. *Arkivit të MMPHI*



Izedin Bytyqi

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI

2. SHTOJCË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1.Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2.Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.